



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin Europian

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.07.2015, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Taulant Balla – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit të datës 7.07.2015.
2. Projektligji “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”.
3. Projektligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Taulant Balla, Esmeralda Shkjau, Ilir Xhakolli, Bujar Derveni, Gramoz Ruçi, Sadri Abazi, Kejdi Mehmetaj dhe Arben Imami.

Mungojnë:

Majlinda Bregu, , Edi Paloka. Gerti Bogdani

(Të) I ftuar:

Klodjan Rrjepaj – zëvendësministër i Shëndetësisë.

HAPET MBLEDHJA

Taulant Balla – Fillojmë mbledhjen.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së kaluar, i cili ju është shpërndarë me email. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Meqenëse sot ishin planifikuar dy mbledhje, propozoj që edhe ligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” të shqyrtohet në këtë mbledhje, pra për të mos bërë dy mbledhje në të njëjtën ditë. Kundër? Nuk ka.

Miratohet.

Arben Imami – Meqenëse nga opozita ndodhem vetëm unë, mirë ishte të prisnim edhe zonjën kryetare që të kishim një qëndrim...

Taulant Balla – Kryetarja është në Bruksel dhe kemi biseduar me të.

Arben Imami – E di që është në Bruksel, por për të pasur një qëndrim më të qartë të opozitës unë shpreha diçka.

Taulant Balla – Zoti Pollo dhe zoti Peza kanë rënë dakord që ta bëjnë mbledhjen sot në orën 12:00, prandaj për këtë efekt ne duhet ta shqyrtojmë sot. Ne jemi komision për dhënie mendimi, kështu që...

Kalojmë te ligji “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”.

Ju lutem, na bëni një prezantim të shkurtër, pa e lexuar relacionin, sepse e kemi përpara.

Klodjan Rrjepaj – Jam zëvendësministër i Shëndetësisë.

Projektligji që keni përpara ka ardhur si rezultat i nevojës që kemi pasur për të rishikuar të gjithë kuadrin ligjor që ka të bëjë me përdorimin e kimikateve, sidomos ato të cilat kanë efekt në shëndetin e njerëzve. Nga ana tjetër, ky ligj është i rëndësishëm për mbrojtjen e shëndetit publik, për shkak se rregullon aspektin e licencimit, të tregtimit, të prodhimit apo edhe të shpërndarjes së të gjitha kimikateve që kanë një efekt të jashtëzakonshëm në parandalimin e vektorëve, të cilët transmetojnë sëmundje në qeniet e gjalla.

Në këtë kontekst, unë besoj që ne e kemi parë si ligj të rëndësishëm bazuar edhe në eksperiencën gati dyvjeçare që kemi tashmë me programin e ri të dezinfektimit që kemi filluar në territorin e Shqipërisë.

Nga ana tjetër, rregullimi i atyre që quhen “tre d-të” (dezinfektimi, dezinfektimi dhe deratizimi) në Republikën e Shqipërisë ka qenë i mangët deri sot, për shkak se janë rregulluar thjesht me një vendim të Këshillit të Ministrave të vitit 1993, ku ngarkohej pushteti lokal për t’u marrë me këtë. Mirëpo, në këta gati njëzet vjet eksperiencë ka pasur mangësi të theksuara për sa i përket aplikimit në terren të lëndëve dezinfektuese, dezinfektuese dhe deratizuese.

Para vitit 1993 ka qenë Ministria e Shëndetësisë ajo e cila është marrë kryesisht me aplikimin e këtyre lëndëve. Tashmë ka dy vjet që Ministria e Shëndetësisë po merret me dezinfektimin kryesisht për insektet (mushkonjat), për shkak se është vënë re një shtim i këtyre lloj vektorëve dhe mund të ketë efekte në shëndetin publik. Po përmend shembullin që është rishfaqur mushkonja, e cila është përgjegjëse për transmetimin e malaries, plus që kemi pasur edhe raste të importuara të malaries.

Në këtë kontekst, kemi pasur një grup pune, i cili ka punuar për ta hartuar këtë ligj dhe për ta sjellë për miratim në parlament.

Taulant Balla – Ka pyetje nga anëtarët e komisionit? Ka diskutime?

E hedhim në votim. Kush është dakord?

Miratohet.

Kolegë të Komisionit të Integrimit zini vend!

Faleminderit, zotërinj përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë!

Mirupafshim!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin Europian

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 14.07.2015, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Taulant Balla – nënkryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Taulant Balla, Esmeralda Shkjau, Ilir Xhakolli, Bujar Derveni, Gramoz Ruçi, Sadri Abazi, Kejdi Mehmetaj dhe. Arben Imami

Mungojnë:

Majlinda Bregu, Gerti Bogdani, Edi Paloka.

Taulant Balla – Kalojmë te projektligji tjetër “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

(Diskutime pa mikrofon.)

Komisioni përgjegjës është ai i Arsimit që e ka mbledhjen në orën 12:00. Atje po bëhet tjetër debat.

Gerti Bogdani – Ata e kanë bërë në parim.

Taulant Balla – Jo, kalon tani.

Ne e kalojmë në parim tani dhe pastaj lëmë një seancë pasdite për ta kaluar nën për nen.

Gerti Bogdani – Pse pasdite? Kalojeni të enjten tjetër.

Taulant Balla – Nuk është në axhendë të enjten.

Gerti Bogdani – Futeni në axhendë të enjten tjetër.

Taulant Balla – Nuk e bëjmë dot.

Gerti Bogdani – A ka seancë të enjten tjetër?

Taulant Balla – Kështu e kemi lënë në Konferencën e Kryetarëve.

Gramoz Ruçi – Është e ngarkuar data 23.

Taulant Balla – Është me ligje dhe...

Gerti Bogdani – Duhet të vijë ministrja, sepse... Në çfarë ore?

Taulant Balla – Unë them ta lëmë në orën 18:00.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk do të lëvizë asnjëri.

Gerti Bogdani – Nga maxhoranca.

Taulant Balla – Edhe ju, se ju e kërkoni.

Dedë, na bëj një prezantim të relacionit.

Dedë Kasneci – Në këndvështrimin e Komisionit të Integritimit?

Taulant Balla – Këndvështrimi ynë, se ne nuk jemi komision përgjegjës. Ka tabelë përputhshmërie?

Dedë Kasneci – Jo, nuk ka. Nuk synon përafrim. Fusha e arsimit quhet plotësuese. Pra, shtetet kombëtare kanë kompetencë, kurse Bashkimi European vetëm (nuk dëgjohet) . E drejta e arsimit parashikohet edhe në Kartën e të Drejtave të Bashkimit European, është në përputhje me frymën dhe me kuadrin e përgjithshëm të legjislacionit të Bashkimit European dhe me kapitullin përkatës të Planit Kombëtar për Rininë 2015-2020.

Taulant Balla – Kush është dakord në parim? Kundër? Dy vota kundër.

Gramoz Ruçi – Çfarë do të diskutojmë nën për nen?

Dedë Kasneci – Nuk synohet përafrim dhe diskutimi nen për nen...

Gramoz Ruçi – Ne do të shprehemi për përafrimin. Çfarë do të shprehim tjetër?

Taulant Balla – Ky është votimi në parim. Në parim jemi dakord që për çështje të veçanta deputetët kanë të drejtë t'i bëjnë pyetje ministres.

Gramoz Ruçi – Pyetjet t'ia bëjmë në seancë.

Gerti Bogdani – Jo në seancë.

Me gjithë respektin për Dedën, po tani nuk mund ta mbrojë Deda këtë?!

Taulant Balla – Dakord.

Me pesë vota pro dhe dy kundër miratohet në parim projektligji.

Gerti Bogdani – Në çfarë ore është mbledhja?

Taulant Balla – Në orën 17:00 ose në 18:00.

Gramoz Ruçi – Cilin ligj ke kaluar nen për nen nga ato që nuk je komision përgjegjës?

(Diskutime pa mikrofon.)

MBYLLET MBLEDHJA